

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“AMBIENTE ALBANIA” sh.p.k

Tiranë më datë 28/04/2021

NENI 1

Shoqëria Tregtare **“AMBIENTE ALBANIA” sh.p.k** (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

NENI 2

Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **“AMBIENTE ALBANIA” sh.p.k**

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin veprimtarive tregtare në Republikën e Shqipërisë, konkretisht:

1. Në fushën e auditimit të energjisë,
2. Kompania ka si objekt kryerjen, në Shqipëri, të veprimtarive të konsulencës, inxhinierisë mjedisore dhe laboratorëve, në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi për këtë temë, në territorin e Republikës së Shqipërisë,
3. Kryerjen e studimeve të fizibilitetit tekniko-ekonomik, kërkimi, konsulenca, trajnimi, planifikimi, lejimi, modelimi numerik, në sektorin publik dhe privat,
4. Konsulencë dhe ndihmë për hartimin, zbatimin e sistemeve të menaxhimit të biznesit dhe / ose njësive publike,
5. Kërkime gjeognostike, hidrogeologjike dhe hidraulike, etj.
6. Projektimi, ndërtimi, blerja, shitja, marrja me qira, instalimi i sistemeve teknologjike, makinerive dhe pajisjeve për kryerjen e aktiviteteve që bien në qëllimin e shoqërisë.

Shoqëria mund të ushtrojë çdo lloj aktiviteti tregtar që legjislacioni i Republikës së Shqipërisë nuk e ndalon.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga e Barrikadave; Qendra Turdiu; K2; N17, Tiranë, Shqipëri.**

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën **20.000 (njëzet mijë) EURO..**

Kapitali ndahet në 1 (një) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

Shoqëria "AMBIENTE" s.p.a, Person Juridik i të drejtës Italiane, regjistruar pranë Camera di Commercio Massa-Carrara Itali, me Numër Regjistrimi 00262540453

Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortakut themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është nënshkruar nga Ortakët Themelues.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat një vjeçar me të drejtë rigjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është **z. Danilo FRASCOLI**, lindur më 06.09.1959 në Legnano, Milano, Itali, shtetas Italian, identifikuar nëpërmjet Pasaportës Italiane me nr. YB5307009, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 1 (një) vit, afat që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, entë publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU

“AMBIENTE” s.p.a

Përfaqësuar nga z. Danilo Frascoli sipas Vendimit të Asamblesë

DANILO FRASCOLI


